

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN QENDËR, FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Qendër, Fier**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 37, datë 28.04.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 86/6, datë 28.4.2014, i ka rekomanduar z. Harrilla Mile Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga zyra e financës të sistemohet me artikull kontabël në ditarin e veprimeve të ndryshme likuidimi i kaluar në llogarinë nr. 602 “shpenzime operative”, në llogarinë nr. 231 “investime”, me qëllim pasqyrimin e saktë në kontabilitet dhe rritjen e vlerës së aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, të kryera në 6 raste për vlerën 746,179 lekë.

Brenda muajit Qershor 2014

2. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të merren masa për hartimin e planit vjetor të kontrolleve në drejtimet e përcaktuara, sipas kërkesave të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 *“Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”*, pika 10, *“Kontrolli tatimor”*.

Menjëherë

3. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të ndiqen hapat ligjore në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011, neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar, me qëllim llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.09. 2003 *“Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, për vlerën **2,107,776 lekë** nga e cila për vitin 2012 për vlerën 1,383,228 lekë dhe për vitin 2013 për vlerën 724,548 lekë.

Menjëherë

4. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të merren masa dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore që duhet të arkëtohen nga njësitë e tjera publike (D.P.SH.T.Rr, ZVRPP) etj, duke bërë rakordime periodike në lidhje me taksën mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme dhe taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit.

Vazhdimisht

5. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me zyrën e financës dhe Policinë e Komunës, të merren masa për arkëtimin e **debitorëve** të pa likuiduara deri më datën 31.12.2013 për të 5 llojet e taksave e tarifave të popullatës në vlerën **14,726, 000 lekë**, përkatësisht: për taksën e tokës, në vlerën 10,623,000 lekë, taksa e banesave në vlerën 717,000 lekë, tarifë e pastrimit në vlerën 771,000 lekë, tarifë varrezash 1,325,000 lekë dhe tarifë ndriçimi 1,290,000 lekë.

Vazhdimisht

6. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me zyrën e financës dhe Policinë e Komunës, të merren masa që në zbatim të procedurave ligjore, për arkëtimin nga 29 subjekte të vlerës **1,408,665 lekë**, debitorë të biznesit të vogël dhe të madh, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i gjobës në masën 25 për qind të detyrimit të pa paguar në afate ligjore, për 21 subjekte në vlerën **118,375 lekë**, gjithsej 1,527,040 lekë.

Vazhdimisht

7. Nga Policia e Komunës të merren masa për hartimin e planit vjetor dhe të dokumentohet puna e përditshme sipas kërkesave të dispozitave ligjore në fuqi dhe të bëhen analiza periodike për realizimin e tij.

Menjëherë

8. Nga titullari i Komunës Qendër Fier, të merren të gjitha masat për inventarizimin, vlerësimin dhe regjistrimin e asetëve në ZVRPP dhe në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin, në zbatim me kërkesat e VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM. nr. 509, datë 06.7.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Fier, të Qarkut Fier”.

Menjëherë

9. Nga titullari i Komunës Qendër Fier, të përgatitet materiali për në Këshillin e Komunës për nxjerrjen e përgjegjësisë financiare në vlerën **41,531 lekë** për gjoba të vendosura nga DRKSHRT Fier për ditë vonesa në kontrollin teknik dhe kolaudimin e dy automjeteve.

Menjëherë

10. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në bashkëpunim me zyrën e financës dhe Policinë e Komunës, të merren të gjitha masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së dëmit prej **1,323,000 lekë**, për 62 subjekte për mospagesën e taksës së biznesit të vogël, nga mos regjistrimi i tyre për veprimtari transporti.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli IV –Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues) të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **230,000 lekë**:

1. Vlera **230,000 lekë** ndaj Kryetarit të Komunës H.M. për përfitim të pa drejtë të shpenzimeve të telefonisë celulare gjatë vitit 2012- 2013 në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në pikën 9 të VKM nr.864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër celular të personave juridikë, publike”.

Brenda muajit Dhjetor 2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe në nenin 10 të kontratës individuale të punës i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Qendër Fier, që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, **për 14 punonjësit** si më poshtë:

a. "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", sipas nenit 12 (Sanksione të kontratës individuale të punës)

1. z. L.K. me detyrë nën kryetar i Komunës në cilësinë e anëtarit në njësinë e prokurimit dhe në komisionin e prokurimit me vlera të vogla.

2. zj. L.DH. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës në cilësinë e kryetarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

-Për shkeljet e konstatuara në zbatimin e detyrave të lëna nga auditin e brendshëm, në hartimin dhe miratimin e buxhetit, në kontabilizimin e detyrimeve për të ardhurat vendore dhe në procedurat e blerjeve në vlera të vogla për vitin 2012 dhe 2013.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika b të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", në nenin 32 "*Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor*" të ligjit 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*", në kreun VI pika 2 "*Prokurimi me vlerë të vogël*" të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "*Për rregullat e prokurimit publik*" i ndryshuar dhe të Udhëzimit të KM nr.2, datë 18.2.2008 "*Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla*", i ndryshuar.

3. z. M.Ç. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës dhe në cilësinë anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

4. z. E.Q. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Administratës dhe në cilësinë anëtarit të KVO dhe të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

5. z. O.K. me detyrë jurist në njësinë e prokurimit dhe në cilësinë anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurat e blerjeve në vlera të vogla për vitin 2012 dhe 2013, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar në kreun VI pika 2 "*Prokurimi me vlerë të vogël*" të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "*Për rregullat e prokurimit publik*" i ndryshuar dhe të Udhëzimit të KM nr.2, datë 18.2.2008 "*Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla*", i ndryshuar.

6. z. B.A. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së taksave vendore.

-Për shkeljet e konstatuara në hartimin dhe miratimin e buxhetit, planifikimin dhe realizimin e të ardhurave vendore dhe mos përmbushje të detyrimeve që rrjedhin në zbatim të nenit 32 "*Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor*" të ligjit 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*" i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore*".

7. Zj. M.S. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

-Për shkeljet e konstatuara në administrimin e pronave, inventarizimin, regjistrimin pranë ZVRPP Fier, vlerësimin dhe zbatimin e një plani menaxhimi e mbarështimi në asetet e qëndrueshme, veprim i cili bie në kundërshtim, me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore*", VKM nr. 22, datë 9.01.2008, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal*", pikat 3, 4 e në vijim.

8. z. RR.V. me detyrë inspektor i Policisë së Komunës.

-Për shkeljet e konstatuara në dokumentimin e punës së Policisë së Komunës dhe mos vendosjen e gjobave në kontrollet e ushtruara sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 8, pikat 9 dhe 15 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar "*Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës*".

Menjëherë

b. "Vërejtje me shkrim" sipas nenit 10 (Sanksione të kontratës individuale të punës)

1. z. A.GJ. me detyrë inspektor i INUV.

Për shkeljet e konstatuara në dokumentimin e punës së Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Vendor të Komunës dhe mos vendosjen e gjobave në kontrollet e ushtruara sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 8, pikat 9 dhe 15 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar

“Për Inspektoratin e Ndërtimit” dhe VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e vendor”.

2. z. L.L. me detyrë specialist në zyrën e taksave vendore.

3. z. J.G. me detyrë specialist në zyrën e taksave vendore.

4. z. E.M. me detyrë specialist në zyrën e taksave vendore.

5. z. A.G. me detyrë specialist në zyrën e taksave vendore.

-Për mos përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”.

6. z. P.GJ. me detyrë punonjës në Policinë e Komunës.

-Për shkeljet e konstatuara në dokumentimin e punës së Policisë së Komunës dhe mos vendosjen e gjobave në kontrollet e ushtruara sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 8, pikat 9 dhe 15 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”.

Menjëherë

Nga Komuna Qendër Fier, me shkresë protokolluar në KLSH me nr. 86/7 datë 21.5.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **ku rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Sotir Kosdine, Përparim Gjuzi dhe Halil Isufi, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT